



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCES

---

**V E N D I M**

**Nr.428, datë 27.07.2016**

**“Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes-Tip “DIGITALB -  
OPERATOR TELEVIZIV”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Eduart	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.07.2016, pasi kishte zhvilluar më parë mbledhjen datë 13.07.2016 dhe seancat dëgjimore me palët e interesit në datat 20 dhe 26 Korrik 2016, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Raporti i “Përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjes midis Digitalb-Operator Televiziv”.

**Baza ligjore:** Nenet 5, 24, *shkronja d*, neni 49 dhe neni 50 (*pika 1*), të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të :

Raportit mbi “Përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes midis Digitalb - Operator Televiziv” dhe dy relacioneve të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe pretendimeve me shkrim dhe në seancë dëgjimore të palëve,

**VËREN SE :**

**I. Procedura e ndjekur**

Ndërmarrja “Digitalb” SH.A, me anë të shkresës së saj nr. 246 prot, dt. 12.02.2016 (protokolluar pranë AK me nr. 82 prot, dt. 16.02.2016) ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës shkresën me lëndë: “Rinjoftim për përjashtim marrëveshje-tip midis “Digitalb dhe Operatorëve Televiziv” për vitin 2016.

Këtë rinjoftim “Digitalb” e bën në vijim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 338, datë 11.11.2014, me anë të të cilit: Komisioni i Konkurrencës ka vendosur: të përjashtojë nga ndalimi marrëveshjen-tip ndërmjet “Digitalb me Operatorët televizivë” deri më date 31.12.2015; si dhe kërkon nga palët në marrëveshje që çdo ndryshim ose amendim i kësaj marrëveshjeje, por edhe rilidhje e saj pas afatit të saj të shfuqizimit më 31.12.2015, do duhet t’i rinjoftohet për përjashtim Autoritetit të Konkurrencës (pika II e dispozitivit).

Kontrata sipas kësaj marrëveshje lidhet me një kohëzgjatje nga data 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor 2018, me një shtrirje territoriale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë kontinentin Europian.

Marrëveshja përmban dispozita kufizuese në kuptim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (vetë Digitalb deklaroi se: nenet e cituara në pikën V.1.2 “Kufizimet” të VKK nr. 338, nuk kanë pësuar ndryshime sa i takon legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen e konkurrencës).

Në ndryshim nga marrëveshja tip e përjashtuar me VKK nr. 338, e cila kishte objekt përfshirjen e 14 kanaleve televizive në platformën satelitore “Digitalb”, marrëveshja e “rinjoftuar” për përjashtim, ka një objekt më të gjerë, pasi ajo synon përfshirjen e 15 kanaleve televizive në platformën tokësore dhe satelitore “Digitalb”, në çdo formë të trasmetimit të tij në SD dhe/ose HD apo forma të tjera të teknologjisë, si dhe kohëzgjatja është për 3 vjet.

Bazuar në nenin 50, pika 4<sup>1</sup> e Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, afati për rinjoftimin për përjashtim të marrëveshjes kishte përfunduar.

Me shkresën nr. 82/2 datë 04.04.2016 “Digitalb” SH.A në përgjigje të shkresës tonë nr. 82/1 datë 07.03.2016, ka paraqitur formularin e njoftimit të marrëveshjes.

Ky njoftim i është nënshtruar procedurës së përjashtimit të marrëveshjeve nga ndalimi të përcaktuar në Seksionin II “Për procedurat për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi”, të Ligjit. Nga shqyrtimi i anekseve dhe kërkesave të formularit rezultoi se njoftimi nuk është i plotë pasi nuk janë paraqitur: të ardhurat në tregun përkatës dhe pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes DIGITALB dhe konkurrentëve të saj të drejtpërdrejtë në nivel tregu; Bilanci i shoqërisë Digitalb për vitin 2015; dhe shprehja e vullnetit të operatorëve televizivë të interesuar ose kontrata e lidhur (firmosur dhe vulosur) me secilin prej këtyre operatorëve duke qënë se kjo marrëveshje përmban dispozita kufizuese të ekskluzivitetit.

## **II. Palët në marrëveshje**

---

<sup>1</sup> Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarojnë pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe **pranohet brenda 3 muajve para mbarimit të afatit të përjashtimit.**

Palët e përfshira në këtë marrëveshje janë operatorët televizivë dhe Platforma Digitalb;

**Digitalb SHA** – është një shoqëri aksionere, e cila ka si objekt të aktivitetit të saj prodhimin, transmetimin dhe shitjen në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video. Digitalb është regjistruar si operator platforme numerike kombëtare satelitore. Shoqëria “Digitalb” ka filluar transmetimet prej korrikut 2004.

**Operatorët Televizivë** – janë operatorët televizivë të cilët sipas Digitalb kanë shprehur gatishmërinë e përfshirjes në këtë marrëveshje si më poshtë: TOP CHANNEL, TOP NEËS, KLAN TV, ORA NEËS, NEËS-24, ABC NEËS, REPORT TV, UTV NEËS, SUPERSONIC, STV FOLK, KANALI FOLKLORIT, SCAN TV, IN TV, MUSICAL dhe CITY TV.

### **III. Përshkrimi i marrëveshjes**

**Objekt i marrëveshjes** është: përfshirja ekskluzive në platformën toksore dhe satelitore “DigitAlb” të kanalit televiziv “X TV” në çdo formë të trasmetimit të tij në SD dhe/ose HD apo forma të tjera të teknologjisë;

Mbartja e kanaleve TV **në platformën numerike Digitalb** të TOP CHANNEL, TOP NEWS, KLAN TV, ORA NEWS, NEWS-24, ABC NEWS, REPORT TV, UTV NEWS, SUPERSONIC, STV FOLK, KANALI FOLKLORIT, SCAN TV, IN TV, MUSICAL dhe CITY TV.

**Qëllimi i marrëveshjes**, është përfshirja në platformën toksore dhe satelitore të kanaleve televizive të 15 operatorëve televiziv, i cili konsiston në ritransmetimin e sinjalit të kanalit në valë toksore dhe satelitore në kohë reale (live) dhe pa asnjë ndërhyrje në kanal in origjinal. Kanali televiziv do të ritransmetohet përkatësisht i kriptuar/koduar sipas parametrave dhe mbulimit territorial të përdorur nga Digitalb. Koneksioni i nevojshëm për ritransmetimin e kanalit do të bëhet nëpërmjet fibrës optike, apo pajisjeve të tjera

### **IV. Tregu përkatës**

#### **IV.1. Tregu përkatës i produktit**

Referuar marrëveshjes, Digitalb ofron shërbimin e përfshirjes në platformën toksore dhe satelitore të kanalit televiziv, ku shërbimi konsiston në ritransmetimin e sinjalit të kanalit në valë toksore dhe satelitore. Ritransmetimi i njëkohshëm në kuptim të shërbimit është transmetimi i kanalit televiziv në kohë reale (live) dhe pa asnjë ndërhyrje në transmetimin origjinal. Si konkluzion, treg përkatës produkti do të konsiderohen transmetimet me pagesë të përmbajtjes televizive.

#### **IV.2. Tregu përkatës gjeografik**

Meqenëse shërbimi përkatës ofrohet në të gjithë territorin atëherë si treg gjeografik, do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

### **IV.3. Tregjet e prekur**

Tregu i prekur është tregu i shpërndarjes së përmbajtjes televizive apo programacionit televiziv të operatorëve televiziv në territorin shqiptar ku arrin sinjali Digitalb.

### **V. Struktura e Tregut**

Aktualisht në Shqipëri sipas licensimit nga organi kompetent veprojnë dy platforma numerike satelitore “Digitalb SH.A” dhe “TRING SH.A”

Shërbimi i transmetimit të kanaleve në platformën digitale tokësore dhe satelitore ka hyrë si risi në vitin 2004 nga shoqëria **Digitalb Sha**. Ky operator ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore dhe satelitore.

**Tring Tv Sh.a** është konkurrenti i vetëm direkt i Digitalb-it në tregun e televizionit me pagesë. Tring vepron gjithashtu në tregun e televizionit me pagesë si (i) një operator distributor paketash me kanale (ii) një operator editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira),(iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit numerik dhe rrjetit satelitor, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit kabllor dhe IP1V12-së.

**Operatorët Televizivë.** Numri i operatorëve televizivë që janë pjesë e platformës DGA aktualisht është 15 dhe sipas DGA këto përbëjnë një numër të vogël të operatorëve televizivë sot në treg

**Operatorët kabllorë.** Ndërkohë, në tregun e televizionit me pagesë veprojnë edhe disa operatorë kabllorë, të licensuar si ripërsëritës programi, të cilët transmetojnë vetëm nëpërmjet teknologjive që nuk mbështeten në frekuenca (kabëll, rrjet komunikimesh elektronike, IPTV etj.).

Këta operatorë tentojnë gjithashtu të hedhin në treg paketa kanalesh televizive me pagesë. Këta Operatorë Kabllorë ritransmetojnë kryesisht paketat Digitalb, ose kushtet e diktuar nga Digitalb.

Në analizën e tregut përkatës të televizionit me pagesë duhet të kemi parasysh se nëse e kuzifojmë analizën vetëm te dy platformat që prodhojnë dhe transmetojnë programe rezulton se **Digitalb** për vitin **2015** rezulton të ketë 79%, ndërsa **Tring** 21%.

Por në fakt tregu i transmetimeve televizive me pagesë është shumë më i gjerë si në aspektin e subjekteve të licensuara nga rregullatori Autoriteti i Medias Audiovizive(AMA) ku përfshihen platforma kabllorë, satelitore dhe tokësore që veprojnë në zona më të kufizuara gjeografike por edhe platforma të palicesuara (informale) të cilësuar në aplikimin e Digitalb për pëjashtimin e marrëveshjes.

Për këto arsye një ndarje e saktë e tregut sipas të ardhurave nga shitja për abonentët dhe/ose nga marketingu nuk disponohet nga AMA dhe është e pamundur të llogarritet nga autoritetet në kushtet e veprimtarisë së subjekteve të

palicensuara dhe shkallës së lartë të informalitetit të subjekteve të licensuara në territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë.

## **VI. KUSHTET PËR PËRJASHTIM**

Bazuar në kontratën Tip (këtu e më poshtë TIP) miratuar me Vendimin nr. 1 datë 31.12.2015 “Për miratimin në parim të draftit TIP “Për kontratën e përfshirjes së kanaleve televizive në platformën DIGITALB” vëmë re se pikat e mëposhtme mund të përbëjnë kufizim të konkurrencës në kuptim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar):

### **Në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e X TV” vëren se:**

1. **Në pikën 2** përcaktohet se: “X TV është e detyruar të mos ofrojë për transmetim kanalën ndaj asnjë platforme/operator tjetër satelitor, tokësor, kabllor, IPTV, Mobile TV, OTT, Catch up TV, apo çdo formë tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda Territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe kontinentit Evropian”.
2. **Në pikën 4** përcaktohet se: “X TV nuk mund të transmetojë në faqen e saj ËEB në kohë reale apo në transmetim direkt”.
3. **Në pikën 5** përcaktohet se X TV nuk mund të jetë pjesëmarrës apo negociues në tendera që transmetojnë evente sportive Pay TV.
4. **Në pikën 6** përcaktohet se: “X TV Channel, me lidhjen e kësaj kontrate do të bëjë me dije çdo autoriteti shtetëror, publik dhe privat se të drejtat e transmetimit të kanalit i takojnë vetëm Digitalb dhe asnjë operatori tjetër televiziv. Në rastet e transmetimit të paligjshëm të kanalit, X TV me kërkesën e Digitalb, do të jenë pjesë e mbrojtjes së të drejtave të transmetimit të kanalit në të gjithë format që parashikon legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave nga Mbajtësi i ligjshëm i tyre”.

### **Në nenin 6 “Të Drejtat dhe Detyrimet e DGA” vihet re se:**

1. Sipas pikës 2 “Digitalb përfiton të drejtën ekskluzive të transmetimit dhe distribucionit televiziv të kanalit X TV në të gjitha format e njohura të transmetimit (satelitor, tokësor, kabllor, internet, Pay Tv, Free Tv, PPV, IPTV, mobile tv, OTT, shërbim on line, ofruet shërbimi përfshirë aksesin e kushtëzuar etj, sipas legjislacionit në fuqi për mediat audiovizive). Digitalb me anë të kësaj kontrate është zotëruesi i vetëm i të drejtave për distribucionin e kanalit për ritransmetimin e njëkohshëm apo të vonuar në çdo mënyrë transmetimi, përveç atij analog të cilin e zotëron vetë X TV në zonën e përcaktuar, sipas licensimit të tij nga organi kompetent AMA”.

### **Në nenin 8 “Ndalimi i konkurrencës” përcaktohet se:**

**Në pikën 1** - Gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës X TV nuk do të ndërmarre asnjë detyre apo veprimtari të ngjashme me atë të përcaktuar në objektin e kësaj Kontrate, për llogari të palëve të treta të cilat mund të jenë në

*konkurrencë me "Digit-Alb", të konsideruara platforma PAY TV, të çdo lloj forme teknike transmetimi brenda territorit dhe afatit të kësaj kontrate.*

**Në pikën 2** - Në rast se X TV merr dijeni për transmetime të paautorizuara të kanalit X TV, brenda territorit të kontratës, X TV do të jetë përgjegjës që:

- i. të njoftojë menjehere DigitAlb me një nga format e pranuar të komunikimit (përveç rasteve kur X TV është njoftuar nga vete Digitalb për shkeljen); dhe*
- ii. të njoftojë autoritetet përkatëse në Territor për çdo shkelje të legjislacionit të zbatueshëm dhe të kerkojë zbatimin e këtij legjislacioni në fuqi.*
- iii. Të bashkëpunojë me DIGITALB për parandalimin dhe ndalimin e piraterisë së transmetimeve të paligjshme të kanalit.*

## **VII. ANALIZA E KONKURRENCËS**

Një marrëveshje përjashtohet nga ndalimi sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit "Për Mbrotjtjen e Konkurrencës" nëse kontribuon në përmirësimin e prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve, nxitjes së progresit teknologjik apo ekonomik me kushtin që një pjesë e përfitimeve të shkojnë në favor të konsumatorëve.

Sigurisht që çdo marrëveshje që kërkon përjashtim përmban klauzola antikorruese por nuk duhet të kufizojë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet objekt i kësaj marrëveshje.

Me anë të kësaj marrëveshje operatorët e kanaleve televizive i akordojnë Digitalbit ekskluzivitetin e ritransmetimit dhe distribucionit të programeve të tyre në televizionin me pagesë.

Në këtë mënyrë përmbajtjet pa pagesë të disa kanaleve televizive, bëhen gjithashtu pjesë e përmbajtjeve me pagesë në tregun e televizionit me pagesë me një cilësi të shtuar.

Sipas nenit 5 të Ligjit 9121, mund të përjashtohet nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 çdo marrëveshje, e cila kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik, nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve e të konsumatorëve dhe kur: nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur; nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.

***Marrëveshja vertikale mund të kontribuojë për përmirësimin e shpërndarjes. Sipas DGA*** në kushtet e një tregu ku pirateria mbizotëron operatorët televizivë janë të interesuar për të bashkëpunuar me një platformë e cila ofron siguri dhe cilësi. Teknologjia e ofruar nga DGA në transmetimin për publikun e gjerë është në nivelin më të lartë dhe transmetimi në high definition në disa lloj formatesh që operatorë të tjerë nuk mund të ofrojnë. Platforma Digitalb i ofron operatorëve televizivë analogë

ritransmetimin në forma të tjera si ato kabllore dhe IPTV, pra një treg akoma më i gjerë për këto kanale.

***Marrëveshja vertikale i lejon konsumatorit të ketë një pjesëmarrje të drejtë në këto përfitime.*** Sipas DGA, konsumatorët final përfitojnë nga Marrëveshja qofte në mënyre sasiore, duke qene se u rritet oferta, pra u shtohen kanalet televizive qe mund te përfitojnë ndërmjet transmetimeve satelitore e numerike tokësorë te Digitalb, qofte cilësia e ofertës, duke qene se transmetimet dhe përmbajtja televizive qe do te përfitojnë do te jene me cilësore, duke qene se vete operatoret televiziv kane përfitime financiare nga Marrëveshja, te cilat ndikojnë ne prodhimin e ofrimin e një programacioni me cilësor. Gjithashtu, ne mënyrë te pashmangshme ky zhvillim sjell dhe rritje te konkurruesmerise ndaj operatoreve te tjerë kabllore te cilët do te synojnë te konkurrojnë me çmime dhe oferta televizive me te mira, qe shkojnë ne përfitim te konsumatorit final.

Nga analiza e mësipërme, nga pjesa e lartë e tregut si dhe nga dispozita e vendosur në kontratë në nenin 5 pika 2, DGA kushtëzon operatorin televiziv në përfshirje të vetëm në këtë platformë, duke kufizuar mundësinë e konsumatorëve në përzgjedhjen e platformave digjitale, pra në mënyrë indirekte përjashton konkurrentin e tij në tregun e prekur, i cili ka një pjesë tregu me diferencë të madhe nga Digitalb.

Gjithashtu kufizimi i vendosur në Marrëveshjen TIP kufizon shpërndarjen e piraterisë dhe kontribuon në shpërndarjen sa më të gjerë të kanaleve kombëtare dhe lokale.

### **VIII. OPINIONET E PALEVE NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E NJOFTUAR**

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancën dëgjimore për të cilat palëve ju dha mundësia për tu shprehur, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Konkurrencës për pjesëmarrje në seancë dëgjimore palët e interesuara paraqiten përpara Komisionit të Konkurrencës parashtrimet e tyre: ndërmarrjet kërkuese "ABCOM", TRING dhe Shoqata e Transmetuesve Televizive Kabllore e Valore Lokale më datë 20.07.2016; Digitalb më datë 26.07.2016, si dhe rregullatori AMA (Autoriteti i Mediave Audiovizive) më datë 20.07.2016.

ABCOM në seancën dëgjimore solli argumente se: Tregu ka dominancë në fushën e ripërsëritjes, se në treg janë dy prodhues të mëdhenj të kontentit DGA dhe Tring ku Tring përfaqëson rreth 18-20% të tregut. Përfaqësuesit e Tring u shprehen se duhet të hiqet ekskluziviteti që ka DGA dhe t'u ofrohet të gjithë platformave kanalet Klan dhe Top Channel.

Shoqata e Transmetuesve Televizive Kabllore e Valore Lokale në seancën dëgjimore solli argumente se Top Channel dhe Klan duhet të jenë pa pagesë sepse me ligj kanalet kombëtare duhet të jenë free to air dhe se ligji "Për mediat

audiovizive” në nenin 87 përcakton se AMA ka të drejtë t’u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive me interes të përgjithshëm për publikun, me qëllim marrjen e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.

Në seancën dëgjimore Tring solli argumente se marrëveshja e propozuar për përjashtim është një marrëveshje ekskluzive dhe e kundërshton pasi sipas Tring çdo shqiptar duhet të informohet pa pagesë dhe këto kanale shiten si pjesë e kanaleve tek konsumatori.

DGA në seancën dëgjimore solli argumente se: në krahasim me dy vite më parë pjesa e tregut është ndryshuar në disfavorin e saj dhe se konkurenti Tring në raport me tregun përfaqëson 21 %.

Gjithashtu numri i kanaleve që ka marrëveshja është i vogël në krahasim me numrin total të kanaleve që është 15 kanale nga 76 kanale satelitore gjithashtu është dhe mundësia për tu ndjekur edhe nëpërmjet internetit.

Sipas përfaqësuesit ligjor të DGA ekskluziviteti merr rendësi kur ka operatorë kabllorë të peregjistruar në organet tatimore; pagesa që marrin prej DGA i ndihmon operatorët kabllorë; DGA ka qenë i përfshirë në luftën kundër piraterisë; është në dobi të konsumatorit përfshirja e kësaj marrëdhënieje; nuk pengohet konsumatori.

Si konkluzion, duke qenë se DGA ka një fuqi tregu dhe se të njëjtat përfitime mund të arrihen edhe nëse kanalet kryesore dhe kanalet lokale përfshihen edhe në paketat e operatorëve të tjerë, nuk ka një justifikim objektiv për të vendosur këtë kufizim (ekskluzivitetin) të parashikuar në pikat e mësipërme të marrëveshjes të njoftuar.

## **PËR KËTO ARSYE :**

*Bazuar në nenin 24, shkronja d, neni 5 dhe 50 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni Konkurrencës,*

## **VENDOSI**

**1.** Marrëveshja tip mes Digitalb dhe operatorëve televizivë përjashtohet nga ndalimi për të gjithë operatorët që kanë shprehur vullnetin e tyre për të nënshkruar marrëveshjen në respektim të kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:

- a- **Në nenin 5 të hiqet pika 2** “X TV është i detyruar që të mos ofrojë për transmetim kanal in ndaj asnjë platforme/operator tjetër satelitor, tokësor, dixhital, kabllor, apo çdo forme tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda Territorit të Republikës së Shqipërisë ....”;
- b- **Në nenin 5 të hiqet pika 4** : “X TV nuk mund të transmetojë në faqen e saj WEB në kohë reale apo në transmetim direkt” dhe pikat në vijim, pikat 4.1 dhe 4.2.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**  
(\_\_\_\_\_)

**Zv.Kryetar**

**Koço Broka**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Iva Zajmi**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**